



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.104

2005

janar

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.15, datë 27.12.2005	Për një ndryshim në “Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të miratuar me vendimin e Kuvendit nr.166, datë 16.12.2004.....	3309
Vendim i KM nr.767, datë 6.12.2005	Për disa ndryshime e shtesa në rregulloren e shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.839, datë 17.12.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.....	3309
Vendim i KM nr.792, datë 16.12.2005	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave “Për strukturën dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe të Kuvendit dhe disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore, ndryshuar me vendimet përkatëse”, të ndryshuar” (Ky vendim zëvendëson vendimin e Këshillit të Ministrave nr.792, datë 16.12.2005, botuar në Fletoren Zyrtare nr.99).....	3311
Vendim i KM nr.808, datë 27.12.2005	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.....	3313
Vendim i KM nr.826, datë 28.12.2005	Për shpalljen “Qendër historike” të një zone në qytetin-muze të Beratit dhe miratimin e rregullores së administrimit të kësaj qendre.....	3313
Vendim i KM nr.835, datë 28.12.2005	Për miratimin e listës së mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve dhe mbeturinave të tjera, që ndalohen të importohen, me qëllim ruajtjeje, depozitimi dhe asgjësimi.....	3320

Vendim i KM nr.837, datë 28.12.2005	Për informimin e kontribuesve dhe të përfituesve nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore.....	3320
Vendim i ERE nr.85, datë 27.12.2005	Për transferimin e licencës nga shoqëria “Favina” sh.p.k. te shoqëria “Favina 1” sh.p.k.....	3321
Leje e IPPS nr.3, datë 12.12.2005	Për ushtrimin e aktivitetit për subjektin “Capital IPPS” sh.a...	3321
	Kërkesë me objekt shpronësimit, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, të tipit “Tokë bujqësore arë”, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 220/110/35 kV Babicë, Vlorë.....	3322
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasit Ali Ramadan Cakri.....	3323
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Sokrat Nusiadhi...	3323
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ismet Kacabumi...	3323

VENDIM
Nr.15, datë 27.12.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË “RREGULLOREN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR.166, DATË 16.12.2004

Në mbështetje të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Në nenin 114 të Rregullores së Kuvendit pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Kuvendi shqyrton me debat dhe voton raportin e Komisionit Hetimor në një seancë të veçantë brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij.

Konferenca e Kryetarëve përcakton datën e debatit dhe të votimit në Kuvend të raportit, në të cilin kërkohet shkarkimi i anëtarit të organit kushtetues, si dhe kohën e debatit, sipas nenit 48 të kësaj Rregulloreje.

Në rast se anëtari i organit kushtetues, për të cilin kërkohet shkarkimi, kërkon të dëgjohet në seancë plenare, Kuvendi është i detyruar ta dëgjojë atë.

Raporti i Komisionit Hetimor, që i propozon Kuvendit shkarkimin e anëtarit të organit kushtetues, miratohet nga Kuvendi me shumicën e parashikuar rast pas rasti në Kushtetutë.

Kur raporti për shkarkimin e anëtarit të organit kushtetues nuk merr numrin e kërkuar të votave, ai quhet i rrëzuar.

Për ato raste që parashikohen në Kushtetutë, vendimi i Kuvendit për miratimin e raportit të shkarkimit të anëtarit të organit kushtetues i dërgohet brenda 5 ditëve, sipas rastit, Gjykatës Kushtetuese ose Presidentit të Republikës.”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.767, datë 6.12.2005

PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË RREGULLOREN E SHËRBIMIT TË JASHTËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.839, DATË 17.12.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutes dhe të nenit 49 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në rregulloren e shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.839, datë 17.12.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Në pikën 18.1 të kreut IV, të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“...apo kur ka leje qëndrimi, të lëshuar nga autoritetet e atij vendi.”.

2. Pika 44.2 e kreut VI ndryshohet si më poshtë vijon:

“44.2 Për shqyrtimin e kërkesave për dhënien e gradave diplomatike, komisioni mbledhet vetëm një herë në muaj. Ai merr në shqyrtim të gjitha kërkesat, që plotësojnë, brenda atij muaji,

kushtin kohor të vjetërsisë së nevojshme për gradën e kërkuar, në përputhje me përcaktimet e nenit 38 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe në këtë rregullore, për gradat ministër këshilltar, ministër fuqiplotë dhe ambasador.”.

3. Kreu VIII ndryshohet si me poshtë vijon:

“KREU VIII PARIMET DHE KRITERET PËR DHËNIEN E GRADAVE DIPLOMATIKE

60. Sistemi i gradave, diplomatike e konsullore, mbështetet në kriteret themelore, të veçanta dhe ka karakter unik, sipas normave të përcaktuara në nenet 35, 36, 37 dhe 38 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe në parimet e përgjithshme të legjislacionit për karrierën e nëpunësit.

61. Kërkesa e diplomatit merret në shqyrtim, pasi të jetë verifikuar, paraprakisht plotësimi i kushteve të mëposhtme:

a) Të ketë plotësuar afatin kohor, të përcaktuar në nenin 38 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”;

b) Të ketë, dy vitet e fundit, vlerësimin vjetor të punës jo më ulët se niveli “mirë”;

c) Të ketë arritur rezultate pozitive, të vërtetuara me dëshmitë përkatëse, në kualifikimet e bëra.

62. Për dhënie të gjitha gradave diplomatike merren parasysh këto kriterë:

1. Vjetërsia në shërbimin e jashtëm.

2. Kualifikimet, brenda dhe jashtë vendit.

3. Vlerësimi i punës.

4. Të mos ketë njërën nga masat disiplinore, të parashikuara në pikën 70 të kësaj rregulloreje.

63. Gradat diplomatike, ministër këshilltar, ministër fuqiplotë dhe ambasador jepen në bazë të aftësive drejtuese të nëpunësit të shërbimit të jashtëm, të demonstruara gjatë ushtrimit të funksioneve të niveleve të ndryshme drejtuese në Ministrinë e Punëve të Jashtme apo në përfaqësitë diplomatike, sipas kriterëve të mëposhtme:

a) Nëpunësit e shërbimit të jashtëm, që përfitojnë të drejtën e gradës ministër këshilltar, duhet të mbajnë për jo më pak se tre vjet gradën diplomatike këshilltar dhe të kenë qenë, të paktën një herë, në pozicione drejtuese, të nivelit të mesëm e të lartë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, si shef sektori, drejtor, drejtor i përgjithshëm ose në pozicione të barasvlefshme me to, në kabinetet e Ministrisë të Punëve të Jashtme, të Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit dhe Presidentit;

b) Nëpunësit e shërbimit të jashtëm, që përfitojnë të drejtën e gradës ministër fuqiplotë, duhet të mbajnë, për jo më pak se tre vjet, gradën ministër këshilltar dhe duhet të kenë qenë, të paktën një herë, drejtues të nivelit të lartë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, të Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit dhe Presidentit apo në pozicione të barasvlefshme në përfaqësitë diplomatike;

c) Nëpunësit e shërbimit të jashtëm, që përfitojnë të drejtën e gradës ambasador, duhet të jenë diplomatë karriere, të cilët mbajnë, për jo më pak se tre vjet, gradën diplomatike ministër fuqiplotë dhe që kanë kryer, të paktën, dy mandate në postin e ambasadorit.

63.1 Në raste të veçanta, kur diplomati vlerësohet për aftësi profesionale, me miratimin e titullarit, Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës mund t’i japë, vetëm një herë gjatë karrierës së tij diplomatike, një gradë diplomatike më të lartë se ajo që mban në përputhje me ligjin nr.9095, datë 3.7.2003.”.

4. Në kreun XI bëhen ndryshime dhe shtesat, si më poshtë vijnë:

a) Titulli ndryshon dhe zëvendësohet me “Humbja dhe rifitimi i statusit të diplomatit”;

b) Në shkronjën “b” të pikës 80, fjalia e fundit “Në rastet kur çështja pushohet nga prokuroria ose kur, me vendim të formës së prerë, diplomati fiton pafajësinë, ai rifiton të gjitha të drejtat e pezulluara”, hiqet;

c) Pas pikës 80 shtohet pika 80.1, me këtë përmbajtje:

“80.1 Diplomati e rifiton statusin në shërbimin e jashtëm dhe të gjitha të drejtat e pezulluara kur:

a) titullari miraton rikthimin e nëpunësit, që ka pasur një përvojë pune jo më të vogël se tre vjet në shërbimin e jashtëm dhe është larguar nga ky shërbim, në mënyrë vullnetare, pa kryer shkelje të rënda, të parashikuara në nenin 43 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 dhe në këtë rregullore;

b) në zbatim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, kërkohet rikthimi në punë apo rifitimi i të drejtave të nëpunësit.

5. Në kreun XII bëhen ndryshimet, si më poshtë vijojnë:

a) Titulli ndryshon dhe zëvendësohet me “Marrja e personave jashtë shërbimit të jashtëm”.

b) Pika 81 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“81. Ministria e Punëve të Jashtme, për nevoja të institucionit, brenda dhe jashtë vendit, mund të marrë punonjës për të shërbyer në shërbimin e jashtëm për aq kohë sa vlerësohet e nevojshme. Këta punonjës gëzojnë statusin e diplomatit për aq kohë sa janë në shërbimin e jashtëm, por nuk përfitojnë grada diplomatike. Ata paguhën në bazë të detyrës, për të cilën janë emëruar.”.

c) Pika 81.1 shfuqizohet.

ç) Pika 82 ndryshohet si më poshtë vijon:

“82. Emërimi i diplomatit dhe largimi i tij bëhen me urdhër të Ministrit të Punëve të Jashtme.”.

6. Kreu XIV shfuqizohet.

II. Gradat diplomatike, të përfituara para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në zbatim të rregullores së shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë, të rishihen në përputhje me kriteret e miratuara në këtë vendim.

Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, nuk kanë fuqi prapavepruese. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.792, datë 16.12.2005, i botuar në Fletoren Zyrtare nr.99, datë 29.12.2005 është i pavlefshëm dhe zëvendësohet me vendimin e mëposhtëm.

VENDIM

Nr.792, datë 16.12.2005

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.711, DATË 27.12.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS QENDRORE, ADMINISTRATËS SË PRESIDENTIT DHE KUVENDIT DHE DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE, NDRYSHUAR ME VENDIMET PÛRKATËSE”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Paragrafi i shtatë i shkronjës “b” të pikës 7, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Sekretar i Kryeministrit, i Presidentit, i Kryetarit të Kuvendit, i zëvendëskryeministrit, nënkryetarit të Kuvendit 50 666.”.

b) Paragrafi i fundit i shkronjës “b” të pikës 7, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Sekretar i ministrit, sekretar, sekretar i këshilltarit të Presidentit 40 326.”

c) Në pikën 7, pas shkronjës “b”, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) Shtesa për vjetërsi në punë e punonjësve të përcaktuar në paragrafin 7 dhe të fundit të shkronjës “b” të pikës 7, të jepet, në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi vlerën 9306 lekë”.

ç) Në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në kategorinë “I-b” shtohet emërtimi “Drejtore të Departamentit të Administratës Publike”.

d) Lidhja nr.3 “Kategorizimi i pozicioneve të punës për funksionet e veçanta në Kryeministri dhe ministrinë e linjës”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Numri i punonjësve të parashikuar për Departamentin e Administratës Publike dhe fondi i pagave, shpërblimeve dhe sigurimeve shoqërore, duke filluar nga data 1.12.2005, të kalojnë nga Kryeministria te Ministria e Brendshme.

3. Efektet financiare për Njësinë Antitrafik, për vitin 2005, të përballohen nga buxheti i vitit 2005 miratuar për Ministrinë e Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 14.11.2005 për nëpunësit e Departamentit të Administratës Publike dhe të Njesisë Antitrafik, në Ministrinë e Brendshme, dhe nga data 30.11.2005 për nëpunësit e Kryeministriesë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.3

**KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS PËR FUNKSIONET
E VEÇANTA NË KRYEMINISTRI DHE MINISTRITË E LINJËS**

INSTITUCIONI	POZICIONI	KATEGORIA E PAGËS
Kryeministria	Drejtore të Njësive të Zbatimit të Projekteve të Bankës Botërore	II-a
	Jurist në Departamentin Juridik&të Koordinimit	II-b
	Inspektor në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ& të Antikorrupsionit	II-b
	Koordinator në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive&Koordinimit Strategjik me Donatorët	II-b
Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale	Drejtore të Inspektoratit Shtetëror të Punës	II-a
Ministria e Punëve të Jashtme	Përfaqësues ligjor i Zyrës së Përfaqësuesit Ligjor	II-b
	Përfaqësues i Zyrës së Minoriteteve	II-b
	Drejtore të Institutit të Diasporës	II-b
Ministria e Mjedisit	Kryeinspektor i Inspektoratit të Mjedisit	III-a
	Inspektor në Inspektoratin e Mjedisit	III-b
Ministria e Drejtësisë	Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor	III-a
Ministria e Brendshme	Drejtore të Njësive Antitrafik	II-a
	Përgjegjës sektori në Departamentin e Administratës Publike	II-b
	Koordinator në Njësinë Antitrafik	III-a
Ministritë e linjës	Inspektor në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm apo sektorët e auditimit të brendshëm	III-b

VENDIM
Nr.808, datë 27.12.2005

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2005, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
ARSIMIT DHE TË SHKENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 8 e 10 të ligjit

nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, zëri “Shpenzime korrente”, t’i shtohet fondi prej 280 000 000 (dyqind e tetëdhjetë milionë) lekësh, për shpërblimin e punonjësve mësimorë të sistemit parauniversitar.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë për politikën e pagave, miratuar në buxhetin e vitit 2005.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.826, datë 28.12.2005

PËR SHPALLJEN “QENDËR HISTORIKE” TË NJË ZONE NË QYTETIN-MUZE TË
BERATIT DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT TË KËSAJ
QENDRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 23, 29, pika 2 dhe 31, pika 1, të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Qendër historike”, në qytetin-muze të Beratit, të zonës, sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e rregullores “Për administrimin e Qendrës historike të qytetit-muze të Beratit”, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe bashkia e Beratit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të shpallë monumentet e kategorisë I dhe II në zonat muze dhe në ato zona të mbrojtura, brenda Qendrës historike të qytetit-muze të Beratit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
E ADMINISTRIMIT TË QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT MUZE TË BERATIT

Neni 1
Qëllimi dhe objektivat

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për administrimin, mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e Qendrës historike të qytetit-muze të Beratit të shpallur, si të tillë me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 172, datë 2.06.1961.

Objektivat kryesorë të kësaj rregulloreje janë:

1. Administrimi i Qendrës historike të qytetit-muze të Beratit sipas hartës, që i bashkëngjitet kësaj rregulloreje si pjesë integrale e saj.

2. Mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore të Qendrës historike të qytetit-muze të Beratit.

3. Mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore të qytetit të Beratit për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të Qendrës historike të qytetit-muze të Beratit.

Neni 2

Struktura e Qendrës historike të qytetit-muze të Beratit

Qendra historike e qytetit-muze të Beratit për vlerat historike, urbanistike, arkitektonike dhe si pjesë e trashëgimisë kulturore i nënshtrohen ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore” dhe ligjit nr.9386, datë 4.5.2005 “Për muzetë”. Qendra historike e qytetit-muze të Beratit përbëhet nga:

1. Qendra historike

2. Zona e mbrojtur

3. Zona e lirë

sipas hartës bashkëngjitur, pjesë integrale e rregullores.

Neni 3

Qendra historike

Qendra historike është pjesa më me vlerë e qytetit të Beratit. Ajo ruhet në tërësinë e saj, si kompleks monumental urbanistik, arkitektonik dhe ambiental. Në këtë zonë nuk lejohen ndërtime të reja. Plotësimi i nevojave me të domosdoshme të këtij qyteti me ndërtime administrative dhe social kulturore të zgjidhet kur kjo është e mundur, duke shfrytëzuar monumentet e kulturës që ruhen brenda kësaj zone, pa cenuar vlerat për të cilat ato janë vënë në mbrojtje.

Neni 4

Kufijtë e Qendrës historike

Qendra historike përmbledh brenda kufijve të saj:

Lagjen Kala, lagjen Mangalem, lagjen Goricë, si dhe Qendrën Mesjetare Islamike.

Kufijtë e saj janë: Lapidari në qafën e kalasë, ndjek rrugën e vjetër që zbret në qendër të Beratit, duke e përfshirë atë në të dy krahët, kthehet te Qendra Islamike me xhaminë Mbret, Teqenë Helvetive dhe Konakët e Teqesë. Këtu përfshihen të gjitha mjediset dytësore dhe portat e banesave që rrethojnë Qendrën Islamike, del te cepi i merkatës dhe në rrugën kryesore. Nga këtu merr rrugën drejt Mangalemit, pas shtëpisë së kulturës duke e përfshirë dhe rrugën, dhe del para xhamisë së Beqarëve dhe kalon drejt, del matanë lumit në Goricë.

Lagja Goricë përfshihet me gjithë kurorën e gjelbër deri në izoipsin 200 m, zbret në drejtim të urës së Goricës, del në rrugën kryesore duke u ngjitur përbri memorialit të Skënderbeut, ngjitet deri në izoipsin 150 m mbi banesat e lagjes Muzaka, duke pasur brenda dhe kurorën e gjelbër poshtë mureve të kalasë dhe bashkohet te lapidari në qafën e kalasë.

Neni 5

Zona e mbrojtur

Zona e mbrojtur me vlerën e saj plotësuese urbanistike, arkitektonike dhe ambientale luan një rol me rëndësi të veçantë në tërësinë e Qendrës historike.

Në zonën e mbrojtur, gërmimet, restaurimet dhe çdo veprim tjetër bëhen në përputhje me nenin 33 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”. Në zonën e mbrojtur të Beratit,

në ndërtimet ekzistuese të pashpallura monument kulture të kategorisë së I-rë apo të II-të, janë përdorur materiale të tjera përveç gurit, suvatimi i jashtëm është i detyruar.

Dritaret si dhe strehët dhe në përgjithësi elementet që dalin në pamjen e jashtme të banesës, siç janë muret rrethuese, ndërtohen sipas formave të vjetra të banesës beratase. Muret rrethuese ndërtohen gjithmonë me gurë, ndërsa porta e jashtme ndërtohet prej druri sipas formave tradicionale. Për të gjitha këto punime projekti përkatës miratohet nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, KKR, mbështetur rregullores tekniko-normative të miratuar nga KKR, dhe konform standardeve ndërkombëtare të vendosura nga UNESCO.

Për përmirësimin e gjendjes në zonën e mbrojtur të Beratit, dhe për të vënë më mirë në pah vlerat e urbanistikës së saj, Instituti i Monumenteve të Kulturës në bashkëpunim me bashkinë e Beratit bëjnë studime të pjesshme, për ritrajtimin arkitektonik të ndërtesave ekzistuese.

Kufijtë e zonës së mbrojtur përfshijnë: majën e kodrës në kalanë e Biftës duke kaluar në izoipsin 200 m, zbret drejt Lagjes së Bregut ku lë brenda zonës gjithë faqen që duket nga qendra e Beratit , me pronësitë 9/48, 9/47, 9/46, 9/45, 9/40 , 9/32, 9/25, kalon në rrugën 9/20 duke lënë brenda zonës pronësitë 10/59, 10/60, 10/61 , ndjek rrugën 10/58, 10/27, lë brenda pronësitë. 10/29, 10/52, 10/103, 26/59,26/6 1, 26/56, 26/44, 26/39, 27/9 ndjek rrugën 27/6, lë brenda 1/ 2, 1/ 4, 1/10, 1/21. 1/14, 2/47, 2/17, del në rrugën 2/36, ndjek rrugën 2/50, duke përfshirë kodrën e Shën Thanasit ku përfshihet maja e saj me izoipsin 150 m, zbret në rrugicat 3/129, 3/124. 3/120, ndjek rrugën 5/152, që të nxjerrin te burimi në rrugën kryesore 15/4, mban stadiumin e vjetër brenda saj, mban rrugën 14/75 dhe pronën 13/8, kalon lumin dhe ngjitet drejt kurorës së gjelbër në Goricë në izoipsin 275 m, përfshin rrënojat e kalasë së Goricës dhe zbret poshtë urës së Goricës duke përfshirë godinën e shekullit të 20-të, 14/124 së bashku me ish-mullirin pranë urës, ngjitet në rrugën perëndimore të kalasë mbi lagjen “Muzaka” dhe bashkohet te kodra e Biftës. Vija e ndarjes shpjegohet grafikisht në hartë me hollësitat e kufirit.

Neni 6 **Zona e lirë**

Zona e lirë është pjesa e qytetit, që nuk përfshihet në dy zonat e lartpërmendura, por është në afërsi të saj. Në këtë zonë lejohen adaptime, shtesa dhe ndërtime të reja, por në çdo rast duhet t'u nënshtrihen veçorive ndërtimore të Qendrës historike të Beratit, duke përmbyshur kushtet e mëposhtme:

a) Adaptimi dhe shtesat në ndërtimet ekzistuese mund të bëhen, por pa cenuar karakteristikat e përgjithshme të Qendrës historike të Beratit (përmasat, volumet, materialet, ngjyrat etj.).

b) Në ndërtimet e reja të respektohet karakteri i ndërtimeve të Qendrës historike (volumet, ngjyrat, mbulesat, katet etj.).

c) Ndërtimet e reja në zonën e lirë të mos kalojnë pesë kate.

Neni 7 **Kategoritë e monumenteve**

Monumentet në qytetin e Beratit ndahen sipas vlerës së tyre në dy kategori: në monumente të kategorisë së I-rë dhe monumente të kategorisë së II-të.

Ndarja e monumenteve në kategori ka për qëllim që, krahas diferencimit të tyre sipas vlerës të shkallëzohet në masë dhe metoda të ndërhyrjes për konservimin, restaurimin, përshtatjen dhe shfrytëzimin e tyre.

Neni 8 **Monumentet e kategorisë së I-rë**

Monumentet e kategorisë së parë janë shembulli më me vlerë i gjinive, tipave dhe të evolucionit të tyre gjatë shekujve që ruhen në Qendrën historike. Monumentet e kësaj kategorie ruhen si në Qendrën historike, në zonën e mbrojtur dhe në zonën e lirë. Si pjesë e monumentit është edhe

oborri, ndërtimet ndihmëse dhe muret rrethuese. Monument i kategorisë së parë mund të jetë edhe një pjesë e banesës, një ambient i vetëm apo disa elemente përbërëse të banesës. Në këtë kategori monumentesh, nuk lejohet asnjë lloj ndërhyrjeje që prek kompozimin e volumeve, trajtimin arkitektural të pamjeve të jashtme dhe të brendshme (me përjashtim të ambienteve higjieno-sanitare), si dhe zgjidhjen planimetriko-funksionale. Restaurimi kryhet me material të njëjtë apo të ngjashëm me origjinalet. Monumenteve të kategorisë së parë që ruhen në zonën e lirë, i vihet në mbrojtje edhe ambienti përreth, të paktën 50 m nga muret rrethuese, e cila caktohet sipas rasteve të veçanta nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, në përputhje me nenin 32 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”.

Neni 9

Monumentet e kategorisë së II-të

Në Qendrën historike të Beratit, monumente të kategorisë së dytë janë të gjitha ndërtimet, përveç monumenteve të kategorisë së parë që ruhen brenda saj. Monumentet e kategorisë së dytë, me vlerën e tyre, luajnë një rol me rëndësi të dorës së parë në tërësinë e ansambleve urbanistike, arkitektonike dhe ambientale të Qendrës historike.

Në monumentet e kësaj kategorie lejohen ndryshime apo përshtatje të brendshme për një shfrytëzim më racional e më komod, duke përdorur për këtë qëllim dhe materiale të reja, me kusht që të mos cenon pamjen e jashtme të tyre.

Kur brenda këtyre monumenteve, sidomos në objektet e banimit, ruhen ambiente karakteristike, si dhe gdhendje në dru, punime në allçi, dekorime pikturale ose mobilje arkitektonike me vlerë, këto ruhen në vendin ku janë.

Neni 10

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve restauruese

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve për konservim, restaurim të monumenteve të kategorisë së parë dhe të dytë, bëhet nga Instituti i Monumenteve të Kulturës apo institucione dhe subjekte të tjera të specializuara dhe të pajisura me lejen përkatëse, sipas ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”.

Neni 11

Subjektet që kryejnë ndërhyrjet restauruese dhe konservuese

Punimet konservuese dhe restauruese në të gjitha monumentet, duke përfshirë dhe muret rrethuese, portën e jashtme, kryhen nga DRMK Berat dhe subjekte të tjera të licencuara sipas ligjit. Për monumentet e kulturës pronë private, pjesa e shpenzimeve që i takon pronarit dhe mënyra e shlyerjes së tyre, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 12

Ndërtimet e reja në planet rregulluese të qytetit-muze dhe mjediset e gjelbëruara

Planet rregulluese të Beratit jashtë Qendrës historike të kenë karakter harmonizues me traditën. Brenda zonës së mbrojtur, çdo lloj ndërtimi të jetë në volumet tradicionale dhe asnjëherë pengesë për soditjen e Qendrës historike. Pylli i pishave që rrethon muret e kalasë, ulet në masën e zbulimit të mureve, e parë kjo nga qendra e qytetit.

Brenda zonës së mbrojtur dhe në Qendrën historike ndalohen ndërtimet e reja. Ndërtimet, pamja e të cilave bie ndesh me këtë rregullore, trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.

Gjelbërimet masive me drurë të lartë që pengojnë soditjen e monumentit duhet të studiohen si

nga DRMK Berat, në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës, dhe organet kompetente drejtuese të njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 13

Ndërhyrjet në infrastrukturën e qytetit-muze

Ndërhyrjet në infrastrukturën e Qendrës historike, si: kanalizime, rrjeti telefonik, elektrik etj., duhet të bëhen pasi projekti të jetë miratuar nga KKR. Mbikëqyrja e punimeve bëhet nga DRMK Berat dhe asnjëherë në dëm të monumentit apo ansamblit-muze.

Neni 14

Vendosja e elementeve dekoruese dhe të reklamave

Në monumentin e kategorisë së parë dhe të dytë nuk lejohet vendosja në mënyrë të ekspozuar e elementeve të cilat prishin pamjen dhe pengojnë fotografimin, filmimin dhe soditjen normale.

Nuk lejohet vendosja në dritare e xhamave me ngjyrë përveç llojit tradicional.

Nuk lejohet vendosja e tabelave të ndryshme pa miratimin e DRMK-së Berat.

Nuk lejohet vendosja e reklamave, dekoreve, qofshin këto dhe të përkohshme në kundërshtim me ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”.

Neni 15

Lëvizja e automjeteve

Brenda Qendrës historike, në rrugët e ngushta, kalldrëme apo në monumente të rëndësishme, si ura të vjetra etj. ndalohet kalimi i mjeteve të rënda, mbi 4 tonë, përveç rasteve emergjente, si dhe kur veprojnë forcat madhore. DRMK Berat, në bashkëpunim me bashkinë Berat, harton dhe përcakton planin për mënyrat e lëvizjes dhe parkimit të automjeteve në hyrje të Qendrës historike.

Neni 16

Masat për mbrojtjen e monumenteve të kulturës nga fatkeqësitë natyrore dhe nga zjarri

Çdo objekt, monument kulture, në pronësi private ose shtetërore, brenda Qendrës historike të qytetit-muze të Beratit apo jashtë saj, duhet të jetë i pajisur me fikës portativë konform dispozitave ligjore në fuqi për mbrojtjen nga rreziqet natyrore dhe nga zjarri për objektet, monument kulture të Qendrës historike të Beratit dhe jashtë saj ku ato ndodhen.

Bashkia e Beratit si organ i njësisë së qeverisjes vendore, administratore e qytetit, duhet të krijojë kushte për vënien në efikasitet të rrjetit të hidrantëve.

Neni 17

Komiteti Mbikëqyrës i Qendrës historike të qytetit-muze të Beratit

Pranë DRMK-së Berat krijohet Komiteti Këshillimor i Qendrës historike të qytetit-muze, Berat, i cili është një strukturë këshillimore jofunksionare. Ky Komitet është i përbërë nga 7 anëtarë, prej të cilëve 3 janë përfaqësues të bashkisë Berat, miratuar nga Këshilli Bashkiak dhe 4 ekspertë të fushës, përzgjedhur nga DRMK Berat.

Kryetar i këtij Komiteti është drejtori i DRMK-së Berat. Kjo strukturë këshillon dhe u rekomandon strukturave përgjegjëse të qeverisjes vendore masa për përmirësimin dhe arritjen e standardeve kombëtare për miradministrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit-muze të Beratit.

Ky Komitet funksionon dhe mbledhet sipas rregullores, e cila miratohet në mbledhjen e parë të Komitetit.

Neni 18

Format e bashkëpunimit

Komiteti Mbikëqyrës i qytetit-muze Berat bashkëpunon me organet e pushtetit vendor dhe atë qendror, në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta midis tyre, dhe në përputhje me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”.

Neni 19


Dispozita të fundit

Për shkeljen e kësaj rregulloreje zbatohen dispozitat ndëshkuese të ligjit nr.9048, datë 7.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” dhe nga vendimet e këshillit bashkiak, Berat.

Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të Ministrit të Turizimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Kjo rregullore shoqërohet me hartën përkatëse të Qendrës historike të qytetit-muze të Beratit, si pjesë integrate e kësaj rregulloreje.

MINISTRIA TURIZMIT KULTURES RINISE DHE SPORTEVE
INSTITUTI I MONUMENTEVE TE KULTURES



QENRA HISTORIKE
E QYTETIT-MUZE
TE
BERATIT

MIRATOHET
KRYEMINISTER
Z. SALI BERISHA

MIRATOHET
MINISTER
Z. BUJAR LESKAJ

Vendim Nr. Dt. 2005

INSTITUTI I MONUMENTEVE
TE KULTURES
DREJTORE
EDLIRA CAUSHI

VENDIM
Nr.835, datë 28.12.2005

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË MBETJEVE TË RREZIKSHME, MBETJEVE DHE
MBETURINAVE TË TJERA, QË NDALOHEH TË IMPORTOHEH, ME QËLLIM
RUAJTJEJE, DEPOZITIMI DHE ASGJESIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 22 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve dhe mbeturinave të tjera, që ndalohen të importohen, me qëllim ruajtjeje, depozitimi dhe asgjësimi, në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në Katalogun Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve.

2. Vendimi nr.26, datë 31.1.1994 i Këshillit të Ministrave “Për mbetjet e rrezikshme dhe mbeturinat”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.837, datë 28.12.2005

**PËR INFORMIMIN E KONTRIBUESVE DHE TË PËRFITUESVE NGA SKEMA E
DETYRUESHME E SIGURIMEVE SHOQËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 62/1 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Instituti i Sigurimeve Shoqërore informon kontribuesit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për kontributet e paguara nga ai ose për llogari të tij, për periudhën nga 1 janari 2006 e në vazhdim.

Informacioni të përmbajë të dhëna për kontributet vjetore, në total, si dhe të ndara në muaj. Formulari-tip i informacionit për kontributet e ndryshme të sigurimeve shoqërore miratohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

2. Instituti i Sigurimeve Shoqërore informon pensionistët për përfitimet e caktuara dhe të paguara, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për periudhën nga 1 janari 2006 e në vazhdim.

Informacioni të përmbajë të dhëna për masën e përgjithshme të përfitimit dhe për elementet e saj përbërëse. Formulari-tip i informacionit për përfitimet e caktuara dhe të paguara miratohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

3. Informacioni të bëhet, çdo vit në mënyrë të alternuar, një vit për kontribuesit dhe një vit për përfituesit, brenda gjashtëmujorit të parë të vitit në vazhdim.

4. Kontribuesit e vetëpunësuar dhe ata punëdhënës informohen drejtpërdrejt nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

5. Kontribuesit e punësuar informohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet punëdhënësve të tyre.

6. Pensionistët informohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nëpërmjet agjencive dhe /ose zyrave të pagesës së pensioneve.

7. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.85, datë 27.12.2005

PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS NGA SHOQËRIA “FAVINA” SHPK TE SHOQËRIA “FAVINA 1” SHPK

Në mbështetje të nenit 9, nenit 20 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe pikës 1.4 “Kushtet e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga centralët elektrike ekzistuese me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 27.12.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Favina 1” sh.p.k. për transferimin e licencës nga shoqëria “Favina” sh.p.k. te shoqëria “Favina 1” sh.p.k. për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike në hidrocentralin e Vithkuqit të Rrethit të Korçës,

VENDOSI:

1. Transferimin e licencës nga shoqëria “Favina” sh.p.k. te shoqëria “Favina 1” sh.p.k. me një afat kohor 5-vjeçar.

2. Miratimin e transferimit të aseteve të shoqërisë “Favina” sh.p.k. te shoqëria “Favina 1” sh.p.k. me të njëjtën vlerë aset.

3. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26 të datës 27.05.2005 “Për licencimin e shoqërisë “Favina” sh.p.k. për prodhimin e energjisë elektrike për hidrocentralin e Vithkuqit të Rrethit të Korçës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Pjetër Dema

LEJE

Nr.3, datë 12.12.2005

Në bazë të vendimit nr.3, datë 9.12.2005 të Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve Suplementare, subjektit IPPS “CAPITAL” sh.a. i jepet leja për ushtrim aktiviteti si Institut Privat i Pensioneve Suplementare të llojit të hapur.

KRYEINSPEKTORI

Naim Hasa

KËRKESË PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, të tipit “Tokë bujqësore arë”, që preken nga ndërtimi

i nënstacionit 220/110/35 kV Babicë, Vlorë.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është: KESH sh.a. Tiranë.

Me anën e këtij publikimi, kërkohet të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë së paluajtshme që shpronësohet dhe masën përkatëse të kompensimit, të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për secilin pronar sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15-ditëve nga data e këtij publikimi, personat që kanë emrin në listën emërore, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË “NDËRTIMIT
TË NËNSTACIONIT 220/110/35 KV BABICË, VLORE”**

RRETHI: VLORE
KOMUNA: QENDËR
FSHATI: BABICË E MADHE

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet : Tokë bujqësore arë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	Akt Marrje Toke në Pronësi,Nr.	Nr. i Pasurisë	Sip. që shpronësohet në m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e kompensimit në lekë	Shënime
1.	ISMET	HAMIT	HARUNI	Tokë bujqësore arë	1060	15545	319/5	4400	600	2.640.000	Proc.regjis.përshpejtuar
2.	SABRI	HAMIT	HARUNI	Tokë bujqësore arë	1060	15546	319/4	2200	600	1.320.000	Proc. regjis.përshpejtuar
3.	HAMIT	MUHAMET	HARUNI	Tokë bujqësore arë	1060	15542	319/3	5500	600	3.300.000	Proc. regjis.përshpejtuar
4.	HAJRI	HAMIT	HARUNI	Tokë bujqësore arë	1060	15543	319/2	5500	600	3.300.000	Proc. regjis.përshpejtuar
5.	ZINI	HAMIT	HARUNI	Tokë bujqësore arë	1060	15544	319/1	2200	600	1.320.000	Proc. regjis.përshpejtuar
6.	BEJUSHE		MANAJ	Tokë bujqësore arë	1060	15540	318/8	8000	600	4.800.000	Proc. regjis.përshpejtuar
7.	DAUT	MELEQ	MELEQI	Tokë bujqësore arë	1060	15590	318/6	2000	600	1.200.000	Proc. regjis.përshpejtuar
8.	CANO	DINO	ELMAZI	Tokë bujqësore arë	1060	15570	323/6	1055	700	738.500	Proc. regjis.përshpejtuar
	Totali							30.855		18.618.500	

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibrës vendosi të shpallë të vdekur shtetasin Ali Ramadan Cakri, me vendimin nr.405, datë 9.12.2005.

KËRKESË

Shtetasi Stefo Nusiadhi, i datëlindjes 1935 në Gjirokastër dhe banues në Fier, kërkon shpalljen

të zhdukur të babait të tij Sokrat Nusiadhi.

KËRKUES
Stefo Nusiadhi

KËRKESE

Shtetasi Fatmir Kacabumi, lindur dhe banues në fshatin Kryekuq, Lushnjë kërkon shpalljen të zhdukur të vëllait të tij Ismet Kacabumit, lindur më 1969 në fashtin Kryekuq Lushnjë.

KËRKUES
Fatmir Kacabumi

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot" Tel: 042 555 63; 267 468
Për më tepër informacion vizitoni faqen e internetit:
www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR NGA MINISTRIA E DREJTËSISË 2005

1. REGJISTRI I PËRGJITHSHËM I AKTEVE DHE I VEPRIMEVE NOTERIALE	1000
2. REGJISTRI I TESTAMENTEVE	500
3. REGJISTRI I DEPOZITIMIT TË PARAVE OSE VLERAVE TË TJERA	500
4. INDEKSI ALFABETIK	600

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë).....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET.....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004 ...	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....	2000

BOTIME TË REJA

1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim i II-të)	1500
2. KODI DOGANOR.....	1000
3. KODI DETAR	1000

Doli nga shtypi më 13.1.2006

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë